



Republika e Kosovës  
Municipality of Istog  
Republika Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Republic of Kosovo

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Istog shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë të të përgjithshëm të Inxhinierisë (duke përfshirë elektro-teknologjinë)
<b>Institucioni</b>	Komuna Istog
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00011634
<b>Kodi</b>	RPC0005250
<b>Data e njoftimit</b>	11.05.2023
<b>Afati për aplikim</b>	01.06.2023 - 08.06.2023

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Zhvillon dhe merr pëlqim për planet e punës dhe afatet në koordinim me mbikëqyrësin për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve në fushën e komunikacionit ;
2. Kryen detyrat e parapara sipas planit të punës të miratuar në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat e komunikacionit ;
3. Harton procesverbalet me rastin

e inspektimit dhe propozon marrjen e masave adekuate ligjore në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, përgatit dhe lëshon fletëparaqitje në rast të të shkeljes së dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtja;

4. Mbikëqyrjen inspektuese të rendit të udhëtimit të operatorëve ekonomik transportues; orarit të punës, hyrjet, daljet, parkingjet, inspektimi në stacionin e autobusëve ;
5. Kushtet e transportit të udhëtarëve, evitimi i rreziqeve në rrugë
6. Inspektimi i transportit të mallrave, kontrolli i transportit të mallrave të rrezikshme;
7. Ndalimi i punës së transportuesve ilegal në komunikacionin rrugor;
8. Kryen punët dhe detyrat tjera në

fushën profesionale specifike në përputhje me Ligjet dhe Rregulloret aktuale si dhe punët dhe detyrat të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi.

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, Fakulteti Teknik, Drejtimi i Komunikacionit Rrugor, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Drejtimi i Komunikacionit, Diplome universitare në fushën e Komunikacionit. .
- Diplomë e nivelit të pestë të Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), për profesione deficitare (TIK);
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune.





## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

- Njohuri profesionale për fushën në të cilën zhvillohet konkurrimi;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

